



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:021099
Datë: 11.07.2023
Numri i dokumentit: 04521709

PPP.nr.157/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorës S . H . nga Prishtina, të cilën me autorizim e përfaqëson avokat L . T . nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Obiliqit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat N . M . nga Prishtina, lidhur me çështjen përmbarimore pagesa e borxhit, në shumë prej 333.5 euro, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër Urdhrit për lejimin e Përmbarimit numër P.nr.3645/20, i datës 28.12.2020, të lejuar nga Përmbaruesi Privat A . M . nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 11.07.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Obiliqit, i ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.3645/20, i datës 28.12.2020, i lejuar nga Përmbaruesi Privat A . M . nga Prishtina.
- II. Mbetet në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.3645/20, i datës 28.12.2020, i lejuar nga Përmbaruesi Privat A . M . nga Prishtina.
- III. *DETYROHET debitori që t'ia kompensojë kreditorit shpenzimet e procedurës në shumë prej 117.00 euro, dhe atë në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktvendimi.*

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat A . M . nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, ka lejuar përmbarimin në bazë të Vendimit 01Nr.21-1195, i datës 16.12.2020 dhe vendimit 01Nr.21-1118 të datës 22.12.2020 për korrigjimin e vendimit të lëshuar nga

Inspektorati i Punës i Kosovës, duke e detyruar debitorin që kreditores t'ia paguajë në emër të borxhit për pagat jubilarë shumë prej 229.5 euro, për përpilimin e ankesës në inspektorat shumë prej 104 euro si dhe për përpilimin e propozimit shumë prej 117.00 euro.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, në afatin ligjor, debitori ka paraqitur prapësim. Në prapësim debitori ka theksuar se propozimi për përmbarim është paraqitur në kundërshtim me dispozitat ligjore, dhe prapësimin e tij e mbështet në nenin 71, 1.7 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP) kushti i përcaktuar në dokumentin përmbarues nuk është përmbushur, përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj.

Më tutje ka shtuar se kreditori në kërkesën e tij nuk e ka përcaktuar saktë, por ka lënë shumë dilema dhe paqartësi se çka ka kërkuar, ku në nenin 27, parag. 1 të LPP-së është rregulluar se “1. Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit. 2. Në qoftë se me anë të dokumentit përmbarues nuk është caktuar afati për përmbushje vullnetare të detyrimit, afati i tillë do të caktohet me anë të aktvendimit për përmbarimin, dhe urdhrin për përmbarim, për shtatë (7) ditë. 3. Në rastin nga paragrafi 2. i këtij neni, organi përmbarues e cakton përmbarimin e propozuar nëse debitori brenda afatit që i është caktuar për përmbushje vullnetare nuk e përmbushë detyrimin e tij”.

Debitori e ka kundërshtuar urdhrin për përmbarim edhe për faktin se sa i përket shpenzimeve të procedurës administrative tek Inspektorati i Punës kreditores i është njohur pa nevojë shuma prej 104 euro për përpilimin e ankesës, edhe pse përfaqësuesi i kreditorit ka paraqitur një ankesë për gjashtë persona, e nga ana e Inspektoriatit këto shpenzime atij i janë njohur për secilën palë veç e veç.

Më tutje i ka kundërshtuar detyrimet që dalin nga ana e Kontratës Kolektive, me arsyetimin se debitori nuk është palë nënshkruese e kësaj kontrate, dhe nuk ka obligim e as të drejtë që t'i përmbushë detyrimet që dalin nga kjo kontratë. Kështu ka kërkuar që të pranohet në tërësi prapësimi i paraqitur nga debitori, të shfuqizohet urdhri përmbarimor i përmbaruesit privat, të refuzohet si i pabazë propozimi për përmbarim i kreditorit, të obligohet kreditori t'i përmbushë të gjitha shpenzimet administrative dhe të procedurës përmbarimore dhe të përfundojë në mënyrë të plotë procedura përmbarimore.

Kreditorja ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, në të cilin ka theksuar se asnjë nga pretendimet e debitorit nuk janë të bazuara. Ka theksuar se dokumenti përmbarimor është vendim përmbarimor dhe i ekzekutueshëm, në përputhje të plotë me nenin 27, parag. 1 të LPP-së, pasi që i njëjti i përmban të gjitha elementet e një dokumenti përmbarimor. Sa i përket pretendimit për pagimin e secilës ankesë veç e veç, përfaqësuesi i kreditorit thekson se kanë parashtruar ankesa për secilin veç e veç. Sa i përket pretendimit për mosdetyrimin nga Kontrata Kolektive kreditori thekson se është fakt notor që debitori i paguan pagat dhe kompensimet tjera për punëtorë. Kështu i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit, dhe të obligohet debitori që kreditorit në emër të përgjigjes në prapësim t'ia paguajë shumë prej 117 euro.

Gjykata pas shqyrtimit të prapësimin, analizimit të shkresave të lëndës, pretendimet në prapësim, gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar.

Me nenin 21 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-118 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore parashihet se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”* Ndërsa sipas nenit 22, paragrafi 1, pika 2 të të njëjtit ligj dokument përmbartuese konsiderohet veç tjerash edhe vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi. Paragrafi 2 i nenit 23 sqaron se vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike.

Me nenin 24, paragrafi 5 të LPP-së parashihet se: *“Përmbartimi caktohet [...], ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurë administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po që se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbartimin”*. E sipas nenit 27 paragrafi 1 të të njëjtit ligj: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.”*

Tutje me nenin 6, paragrafi 4 të Ligjit Nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë (ligj ky që ka qenë në fuqi në kohën e lejimit të përmbartimit) parashihet se: *“Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektoratit të punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit”*. Ndërsa, me neni 144, paragrafi 1, pika 3 e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, parashihet se: *“Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues”*.

Në rastin konkret, gjykata ka gjetur se përmbartimi është lejuar në bazë të Vendimit 01Nr.21-1195 i datës 16.12.2020 dhe vendimit 01Nr.21-1118 të datës 22.12.2020 për korrigjimin e vendimit të lëshuar nga Inspektorati i Punës i Kosovës, i cili është parashtruar në kopje të vërtetuar. Me këtë vendim është detyruar debitori që tani kreditorit t’ia paguajë shpërbllimin jubilar në vlerë të 50% të pagës bazë, në shumë të përgjithshme prej 229.5 euro dhe për shpenzime për ankesë shumë prej 104 euro, ndërsa pasi që në vendimin bazë janë përfshirë disa persona, me vendimin për korrigjimin e vendimit bazë është cekur se shpenzimet e procedurës prej 104 euro janë për secilën palë veç e veç. Vendimet në fjalë janë dokumente përmbartuese, ngase i plotësojnë kushtet ligjore nga nenet: 21, 22 paragrafi 1 pika 2, 23 paragrafi 2, neni 24 paragrafi 5 dhe 27 paragrafi 1 të LPP-së, për të qenë i përmbartueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbartim.

Gjykata, vlerësoi se debitori ka dështuar që të parashtrrojë ndonjë provë materiale të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij, ashtu siç është paraparë me nenin 69, paragrafi 4, të LPP-së. Po ashtu, e njëjta gjeti se në rastin në fjalë nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e urdhrin përmbartues, ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 71, paragrafi 1, pika 1 deri në pikën 12 të LPP-së. Më tej, gjykata i vlerësoi si të paqëndrueshme pretendimet e debitorit se përmbartimi është lejuar në bazë të një dokumenti i cili nuk është i përshtatshëm për përmbartim pasi që nuk është paraparë koha për përmbushje vullnetare, sepse në vendimin e lartcekur me të

cilën i është njohur kredia kreditorit, është cekur afati prej tetë ditësh për përmbushje vullnetare, e po ashtu edhe në urdhër për përmbushje është cekur afati prej shtatë ditësh për përmbushje. Sa i përket pretendimit tjetër të debitorit që Inspektorati i Punës pa të drejtë i ka njohur shpenzimet nga 104 euro për secilën palë veç e veç, gjykata vlerëson se ky pretendim nuk mund të jetë objekt shqyrtimi i kësaj procedure, pasi që ky detyrim është caktuar në bazë të vendimit, i cili siç u theksua më lart, përbën titull përmbarimor dhe është i përshtatshëm për përmbarim. As pretendimet që komuna si kreditore nuk ka detyrime nga Kontrata Kolektive nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i kësaj procedure, pasi që edhe kjo kredi është caktuar me vendimin e Inspektoratit të Punës, që përbën titull përmbarimor dhe është i përshtatshëm për përmbarim.

Duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së, me të cilin parashihet se pala e cila humb kontestin duhet t'ia kompensoj në tërësi palës gjyqfituese shpenzimet e procedurës, i cili është i zbatueshëm sipas nenit 17 të LPP-së, gjykata e detyroi debitorin që kreditorit në emër të shpenzimeve të procedurës për përpilimin e përgjigjes në prapësim t'ia paguajë shumën prej 117.00 €, dhe atë në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, gjykata në përputhje me nenin 73 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË
Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.157/21, me datë 11.07.2023.

Gjyqtari

Freskim Musliu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.